

|                                                                                                                                    |      |                                        |          |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|----------------------------------------|----------|
| Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës<br>Komora inženjera Republike Kosovo<br>Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo |      |                                        |          |
| Myrësi org.<br>Org. Jedomica<br>Org. Unit                                                                                          | OIRK | Nr. I Prot.<br>Broj Prot.<br>Prot. No. | 154/26   |
| Nr. I taqova<br>Br. Stranica<br>Nr. Pages                                                                                          | /    | Data:<br>Datum:<br>Date:               | 19.02.26 |
| PRISHTINË / A                                                                                                                      |      |                                        | No.1     |



**ODA E INXHINIERËVE  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

*Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës  
Inženjerska komora Republike Kosova  
Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo*

Në mbështetje të Nenit 12 paragrafit 3, nën-paragrafit 3.1 të Ligjit nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (Gazeta Zyrtare nr. 1, 17 janar 2022) dhe Nenit 18 të Statutit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës për Periudhën e Përkohshme (Nr. 8648/24, 31.12.2024), Kuvendi i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 18/02/2026, miraton:

**RREGULLORE TË PUNËS SË  
KUVENDIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**KAPITULLI I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Kjo Rregullore përcakton rregullat procedurale, organizative dhe funksionale për punën e Kuvendit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi), në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji në fuqi) dhe Statutin e Odës për periudhën e përkohshme.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Kjo Rregullore zbatohet për Odën e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Oda), organet, anëtarët e saj dhe të gjithë personat të përmendur shprehimisht në këtë Rregullore.

**Neni 3  
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin si në vijim:

- 1.1. **Mbledhje online** – mbledhje e Kuvendit të Odës e zhvilluar përmes mjeteve të miratuara të komunikimit elektronik.
2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin në fuqi.
3. Emrat në njërin gjini të përdorura në këtë Rregullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë tjetër, pa diskriminim.

## **KAPITULLI II**

### **PJESËMARRËSIT NË MBLEDHJEN E KUVENDIT**

#### **Neni 4**

##### **Përbërja e Kuvendit dhe pjesëmarrësit tjerë**

1. Kuvendi i Odës përbëhet nga anëtarët e rregullt të Odës, të përcaktuar sipas Statutit të Odës.
2. Pavarësisht paragrafit 1 të këtij Neni, gjatë periudhës së përkohshme të funksionimit të Odës, Kuvendi përbehet nga anëtarët themelues të Odës sipas Nenit 45 të Ligjit në fuqi.

#### **Neni 5**

##### **Pjesëmarrësit tjerë në Kuvend**

Me ftesë të Kryetarit të Odës ose Bordit Drejtues, në mbledhjet e Kuvendit mund të ftohen dhe marrin pjesë anëtarët tjerë të Odës që nuk janë në përbërje të Kuvendit apo edhe palë tjera në cilësinë e vëzhguesve.

## **KAPITULLI III**

### **ÇËSHTJET PROCEDURALE DHE ORGANIZATIVE**

#### **Neni 6**

##### **Thirrja e mbledhjeve të Kuvendit**

1. Mbledhjet e Kuvendit thirren nga Bordi Drejtues apo 1/3 e anëtarësisë së Kuvendit të Odës në përputhje me rregullat e përcaktuara në Statutin e Odës.
2. Ftesat për mbledhjen e Kuvendit bëhen në mënyrë elektronike nga Administrata e Odës, të paktën njëzetënjë (21) ditë para datës së caktuar për mbledhje të rregullt dhe të paktën dhjetë (10) ditë para datës së caktuar për mbledhje të jashtëzakonshme.

3. Në ftesë përfshihet rendi i ditës për mbledhjen e Kuvendit, i miratuar nga Bordi Drejtues sipas Neni 7 në vijim të kësaj Rregulloreje, së bashku me të gjithë dokumentacionin përcjellës sipas pikave të Rendit të Ditës.

4. Çdo Mbledhje të Kuvendit i caktohet numri rendor, duke reflektuar numrin kronologjik të radhës nga Kuvendi i parë themelues i Odës.

#### **Neni 7** **Përcaktimi i Rendit të Ditës**

1. Projekt Rendi i Ditës së mbledhjes së Kuvendit propozohet nga Kryetari i Odës dhe pas shqyrtimit miratohet nga Bordi Drejtues.

2. Secili organ tjetër i zgjedhur i Odës apo 1/3 e anëtarësisë së Kuvendit kanë të drejtë të propozojnë një ose më shumë pika shtesë apo ndryshime në Rendin e Ditës e miratuar, më së voni deri në tre (3) ditë para mbledhjes së Kuvendit.

3. Për propozimin nga paragrafi 2 i këtij Neni, votohet në mbledhjen e Kuvendit, para fillimit të shqyrtimit të pikave tjera të Rendit të Ditës.

4. Rendi i Ditës së bashku me propozimet nga paragrafi 2 i këtij Neni, publikohet në webfaqen e Odës para fillimit të mbledhjes së Kuvendit.

#### **Neni 8** **Regjistrimi i anëtarëve**

1. Pjesëmarrësit në Kuvendin e Odës regjistrohen në hyrje të vendit ku mbahet Mbledhja e Kuvendit. Regjistrimi bëhet nga personeli i caktuar nga Administrata e Odës.

2. Çdo pjesëmarrës duhet të paraqes kartelën e anëtarësisë të Odës gjegjësisht dokumentin e identifikimit me rastin e regjistrimit.

3. Çdo pjesëmarrës që regjistrohet pajiset me distinktivin e pjesëmarrjes, kartat e votimit apo edhe kredencialet elektronike, nëse janë të aplikueshme, për t'i përdorur për proceset e diskutimeve dhe marrjen e vendimeve në Mbledhje.

4. Administrata e Odës organizon aspektet logjistike të regjistrimit dhe sigurimit të vendeve të pjesëmarrësve në Mbledhjen e Kuvendit. Anëtarët e rregullt me të drejtë vote ulen në vende të veçanta nga pjesëmarrësit tjerë në mbledhjen e Odës.

5. Pjesëmarrësit që arrijnë pas fillimit zyrtar të Mbledhjes së Kuvendit mund të regjistrohen në një vend të caktuar të regjistrimit që menaxhohet nga Administrata e Odës. Çdo largim i pjesëmarrësve nga Mbledhja e Kuvendit evidentohet nga Administrata e Odës.
6. Lista zyrtare e pjesëmarrjes në Mbledhjen e Kuvendit mbahet nga Administrata e Odës dhe i bashkëngjitet procesverbalit të Mbledhjes.
7. Mbledhjet e Kuvendit janë të hapura për mediat.

#### **Neni 9** **Gjuhët e Punës së Kuvendit**

1. Gjuhët e punës së Kuvendit janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe, në përputhje me Ligjin në fuqi për përdorimin e gjuhës.
2. Administrata e Odës siguron përkthimin e dokumenteve të Mbledhjes dhe përkthimin simultan në mes të gjuhëve zyrtare për anëtarët e Odës, sipas kërkesave dhe nevojave të tyre.

#### **Neni 10** **Përcaktimi i kuorumit**

1. Në përputhje me Statutin e Odës, Kuvendi ka kuorum kur në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të rregullt që e përbëjnë Kuvendin e Odës.
2. Si rregull, Kuorumi konstatohet nga Kryesuesi i Mbledhjes së Kuvendit në fillim të mbledhjes dhe konfirmohet përsëri para çdo procesi të votimit që zhvillohet nga Mbledhja e Kuvendit.

#### **Neni 11** **Zhvillimi i mbledhjes**

1. Në përputhje me Statutin e Odës, Mbledhjet e Kuvendit mund të mbahen apo vazhdojnë në më shumë se një ditë kalendarike deri në përfundimin e të gjitha pikave të Rendit të Ditës.
2. Me konstatimin e Kuorumit, Kryesuesi i Mbledhjes së Kuvendit e shpall të hapur Mbledhjen e Kuvendit dhe fillon me paraqitjen e Rendit të Ditës, ku si pikë e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbalit të Mbledhjes paraprake të Kuvendit.
3. Për secilën pikë tjetër të Rendit të Ditës, Kryesuesi i Mbledhjes fton prezantuesin e përcaktuar, gjegjësisht anëtarin e rregullt të Odës apo pjesëmarrësin tjetër në Kuvend, për të

elaboruar temën nga pika e rendit të ditës. Kryesuesi i Mbledhjes përcakton kohën e përshtatshme për secilin elaborim, varësisht nga kompleksiteti i temës dhe rrethanat tjera.

4. Pas çdo prezantimi, anëtarët e rregullt që janë pjesëmarrës në Kuvend kanë të drejtë të ndërhyjnë. Ndërhyrjet zgjasin më së shumti tre (3) minuta dhe duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejtë me pikën e Rendit të Ditës që diskutohet dhe janë të limituara në një ndërhyrje për një anëtarë.

5. Prezantuesi i pikës së Rendit të Ditës ka të drejtë replike ndaj çdo ndërhyrje, po ashtu në kohëzgjatje prej tre (3) minuta. Ndërhyrësi ka të drejtë po ashtu në kundër-replikë në kohëzgjatje prej dy (2) minuta, ndërsa replika përfundimtare nga prezantuesi po ashtu lejohet në kohëzgjatje të njëjtë. Kryesuesi i Mbledhjes mund të përcaktoj kohë më të gjatë për ndërhyrjet dhe replikat në rast se kompleksiteti i temës e arsyeton një gjë të tillë.

6. Të gjitha prezantimet, ndërhyrjet dhe replikat gjatë Mbledhjes së Kuvendit regjistrohen në procesverbalin e Mbledhjes.

7. Kryesuesi i Mbledhjes në çdo kohë siguron mbarëvajtjen e mbledhjes, duke menaxhuar kohën e prezantimeve, ndërhyrjeve dhe replikave. Kryesuesi i Mbledhjes mund të tërheqë vërejtjen për ndërprerje, gjuhë fyese ose devijime nga Rendi i Ditës dhe temat e diskutimit.

8. Sjellja e përsëritur e një anëtari të Kuvendit, në kundërshtim me rregullat e mbarëvajtjes së Mbledhjes apo pengimi i punës së Kuvendit, mund të sjell largimin nga seanca me vendim të Kuvendit.

## **Neni 12**

### **Marrja e vendimeve**

1. Në përputhje me Statutin e Odës, vendimet në Kuvend miratohen me shumicën e votave të anëtarëve të rregullt të Odës që janë të pranishëm dhe që votojnë.

2. Votimi në mbledhjet e Kuvendit bëhet vetëm nga anëtari i pranishëm në Kuvend dhe nuk lejohet votimi me autorizim.

3. Votimi bëhet përmes ngritjes së dorës, kartës së votimit apo mënyrës elektronike, siç përcaktohet nga Kryesuesi i Mbledhjes. Votimi i fshehtë bëhet në kutitë e votimit ku Administrata e Odës dhe Komisioni përkatës siguron integritetin e tyre. Mënyra e votimit dhe e numërimit të votave bëhet gjithmonë e ditur para paraqitjes për votim të një vendimi dhe regjistrohet në procesverbal.

4. Të gjitha vendimet e miratuara në Kuvendin e Odës publikohen në webfaqen e Odës.

5. Përveç nëse përcaktohet ndryshe në vendimin e miratuar, vendimet e Kuvendit hyjnë në fuqi ditën e publikimit. Vendimet të cilat kërkojnë miratime të jashtme apo procedura tjera, hyjnë në fuqi pas përfundimit të atyre procedurave përkatëse.

6. Fletëvotimet nga votimi i fshehtë arkivohen nga Administrata e Odës dhe ruhen për periudhën e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për arkivim.

### **Neni 13**

#### **Pezullimi i përkohshëm i mbledhjes**

1. Mbledhja e Kuvendit mund të pezullohet përkohësisht me propozim të Kryesuesit të Mbledhjes dhe miratim të anëtarëve pjesëmarrës të Kuvendit me të drejtë vote. Propozimi për pezullim arsyetohet.

2. Vazhdimi i Mbledhjes së pezulluar të Kuvendit duhet të mbahet në një ditë tjetër, e cila nuk mund të jetë më larg se tridhjetë (30) ditë nga data e pezullimit të Mbledhjes.

3. Në rast të mos ekzistimit të kuorumit në fillim të Mbledhjes së Kuvendit apo humbjes së kuorumit gjatë Mbledhjes, Kryesuesi i Mbledhjes e evidenton këtë dhe me vendim pezullon përkohësisht Mbledhjen për datën tjetër.

4. Njoftimi për pezullim të mbledhjes, duke përfshirë arsyet për pezullim dhe të dhënat tjera, publikohen në webfaqen e Odës.

5. Me rifillimin e mbledhjes së pezulluar, vazhdohet me Rendin e Ditës nga Mbledhja paraprake, përveç nëse Kuvendi voton për të ndryshuar agjendën në përputhje me procedurën e përcaktuar në paragrafin 2 të Nenit 7 të kësaj Rregulloreje.

### **Neni 14**

#### **Përfundimi i mbledhjes**

1. Mbledhja e Kuvendit vazhdon deri sa përfundon shqyrtimi dhe diskutimi i të gjitha pikave të Rendit të Ditës. Pas përfundimit të pikës së fundit, Kryesuesi i Mbledhjes e shpall të mbyllur Mbledhjen e Kuvendit.

2. Në rastet e pengesave të vazhdueshme procedurale apo rrethanave të tjera të cilat e pamundësojnë mbajtjen e Mbledhjes apo perspektivën për mbajtjen e Mbledhjes brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë, Mbledhja e Kuvendit mund të përfundoj edhe para shterimit të Rendit të Ditës,

në rast se propozohet në formën e mocionit nga Kryesuesi i Mbledhjes, 1/3 e anëtarëve të rregullt që marrin pjesë në Kuvendin e Odës apo organet e zgjedhura të Odës.

3. Propozimi nga paragrafi 2 i këtij Neni miratohet me vendim të Kuvendit.
4. Njoftimi për përfundimin e Mbledhjes, duke përfshirë arsyet e përfundimit të mbledhjes dhe të dhënat tjera përkatëse, publikohen në webfaqen e Odës.

### **Neni 15**

#### **Regjistrimi dhe procesverbali i mbledhjes**

1. Administrata e Odës bën regjistrimin e çdo Mbledhje të Kuvendit nga i cili zhvillohet procesverbali. Procesverbali i Mbledhjes përfshin të dhënat si në vijim:
  - 1.1. datën, orën dhe vendin e mbledhjes;
  - 1.2. emrat e anëtarëve të pranishëm dhe pjesëmarrësve tjerë në mbledhje;
  - 1.3. pikat e rendit të ditës të elaboruara dhe diskutuara;
  - 1.4. përmbledhjen e diskutimeve, dhe
  - 1.5. vendimet e miratuara të Kuvendit si dhe rezultatet e votimit.
2. Procesverbali nënshkruhet nga Kryesuesi i Mbledhjes dhe Drejtori Ekzekutiv i Odës.
3. Pas nënshkrimit, procesverbali publikohet në webfaqen e Odës në një kohë të arsyeshme, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se dhjetë (10) ditë. Pas publikimit, çdo pjesëmarrës në mbledhjen e Kuvendit të Odës mund të propozoj përmirësimet e arsyetuara në procesverbal në afat prej dhjetë (10) ditë.
4. Çfarëdo përmirësimi i arsyeshëm që propozohet në procesverbalin e publikuar, shqyrtohet për miratim në mbledhjen e radhës së Kuvendit.

## **KAPITULLI IV**

### **ZGJEDHJA DHE SHKARKIMI I ORGANEVE TË ODËS**

#### **Neni 16**

##### **Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të organeve të Odës**

1. Në përputhje me Statutin e Odës, Lista Zgjedhore përfundimtare për anëtarët e nominuar për organet e Odës i paraqitet Kuvendit për shqyrtim dhe votim. Lista Zgjedhore për Bordin Drejtues me nominimet e bëra, përfaqëson nivelin proporcional të anëtarëve të licencuar sipas drejtimeve të inxhinierisë në fushën e ndërtimit.
2. Kuvendi i Odës emëron Komisionin prej pesë (5) anëtarë nga radhët e anëtarëve të rregullt pjesëmarrës në Kuvend, për të administruar procesin zgjedhor për organet e Odës. Këta anëtarë emërohen me vendim të Kuvendit, në bazë të nominimeve të pranuar.
3. Asnjë nga anëtarët e nominuar për zgjedhje në organet e Odës nuk mund të jetë pjesë e Komisionit Zgjedhor nga paragrafi 2 i këtij Neni.
4. Komisioni Zgjedhor, me mbështetje teknike dhe administrative nga Administrata e Odës, mbikëqyr dhe menaxhon të gjitha aspektet e procesit zgjedhor për organet e Odës, duke përfshirë përgatitjen e fletëvotimeve, mbledhjen e votave, numërimin, shpalljen e rezultateve dhe raportimin.
5. Vota për zgjedhjet në organet e Odës është e lirë, e barabartë dhe bëhet në formë të fshehtë. Secili anëtar i rregullt pjesëmarrës në Kuvend ka të drejtë të votoj nga një të nominuar në secilën kategori të pozitive të hapura në organet e Odës. Votimi për anëtarët e Bordit bëhet sipas nivelit proporcional të përfaqësimit të drejtimeve të inxhinierisë në fushën e ndërtimit.
6. Me përfundimin e votimit, Komisioni Zgjedhor bën numërimin e menjëhershëm të votave në një formë të hapur dhe transparente. Vëzhguesit mund të lejohen të dëshmojnë procesin e numërimit, në përputhje me formën e përcaktuar nga Kryesuesi i Mbledhjes.
7. Kandidati apo kandidatët të cilët marrin numrin më të madh të votave konsiderohen të zgjedhur në organin e Odës në përputhje me numrin e pozitive për të cilat janë shpallur zgjedhjet. Siç përcaktohet me Statutin e Odës, në rast të votave të barabarta votimi përsëritet në mes të anëtarëve me vota të barabarta sipas rregullave të njëjta, deri sa të plotësohet numri i anëtarëve në organet e Odës.
8. Komisioni Zgjedhor përgatit raportin me shkrim të votimit që përmbledh procesin zgjedhor, duke evidentuar edhe çfarëdo parregullsie që mund të jetë shkaktuar. Raporti i dorëzohet Kryesuesit të Mbledhjes dhe publikohet në webfaqen e Odës brenda pesë (5) ditëve nga data e mbajtjes së Mbledhjes së Kuvendit.
9. Procedura e nominimit dhe votimit për anëtarët e organeve të Odës mbikëqyret nga Komisioni Mbikëqyrës i Odës, gjegjësisht Komisioni i Ministrisë për Themelimin e Odës gjatë

periudhës së përkohshme të funksionimit të Odës në rast të zhvillimit të ndonjë procesi zgjedhor për ndonjë prej anëtarëve të këtyre organeve gjatë kësaj periudhe.

#### **Neni 17**

#### **Procedura e shkarkimit të anëtarëve të organeve të Odës**

1. Propozimi për shkarkimin e një anëtari të organit të Odës dorëzohet në Kuvend nga 1/3 e anëtarëve të rregullt të Odës, përmes Administratës së Odës.
2. Ky propozim bëhet me shkrim dhe përfshin arsyeshmërinë e qartë për shkarkimin e anëtarit të organit të Odës.
3. Propozimi përfshihet në Rendin e Ditës për Mbledhjen e menjëhershme të radhës së Kuvendit. Anëtari i propozuar për shkarkim njoftohet për propozimin e bërë dhe i lejohet mundësia për prezantim dhe përgjigje gjatë Mbledhjes së Kuvendit, por para votimit nga Kuvendi.
4. Shkarkimi i anëtarit të organit të Odës bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të rregullt të Odës që janë të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit dhe që votojnë. Votimi për shkarkim bëhet në formë të hapur.
5. Pas shkarkimit të anëtarit, Kuvendi në përputhje me Statutin e zgjedh anëtarin e ri në mbledhjen e radhës.

### **KAPITULLI V - RAPORTIMI NGA ORGANET E ODËS**

#### **Neni 18**

#### **Dorëzimi, prezantimi dhe miratimi i raporteve nga organet e Odës**

1. Raportet e përgatitura nga organet e Odës, qoftë ato periodike apo sipas kërkesës së Kuvendit, i paraqiten me shkrim Kuvendit përmes Administratës së Odës, së paku tridhjetë (30) ditë para datës së parashikuar të mbajtjes së Mbledhjes së Kuvendit. Raportet duhet të jenë në përputhje me udhëzimet e miratuara nga Kuvendi.
2. Raportet e paraqitura i dorëzohen të gjithë anëtarëve të Kuvendit, së bashku me Rendin e Ditës të Mbledhjes së Kuvendit.
3. Secili raport i paraqitur, prezantohet dhe shpjegohet nga përfaqësuesi i organit të Odës që ka hartuar Raportin.

4. Një debat i strukturuar mbahet për secilin raport, në përputhje me përcaktimet e Nenit 11 të kësaj Rregulloreje, ku anëtarët kanë të drejtë të ndërhyjnë, kërkojnë qartësime si dhe propozojnë rekomandime për ndryshimin e Raportit. Prezantuesi i Raportit duhet të jetë i gatshëm t'i përgjigjet pyetjeve dhe ofroj sqarime të nevojshme gjatë Mbledhjes së Kuvendit.
5. Pas debatit të zhvilluar, Kuvendi voton për miratimin ose refuzimin e Raportit. Miratimi i Raportit mund të jetë edhe me rekomandimet e pranura gjatë debatit të zhvilluar.
6. Në rast të mos miratimit të Raportit, shqyrtimi i Raportit shtyhet për Mbledhjen e radhës së Kuvendit. Organi i Odës përgjegjës për raportin përkatës e bën përmirësimin e Raportit dhe e sjell atë në formë të plotësuar për votim, në bazë të vërejtjeve përkatëse të paraqitura nga anëtarët e rregullt të Kuvendit.
7. Raportet e miratuara të cilat përmbajnë rekomandime, veprime të veçanta për të ardhmen apo të gjetura që kërkojnë zbatim i dërgohen organit përkatës të Odës, të cilët janë të detyruar të përgatisin raporte përcjellëse me shkrim për Kuvendin, përmes Administratës së Odës, lidhur me progresin në zbatimin e tyre.
8. Të gjitha raportet e miratuara nga Kuvendi publikohen në webfaqen e Odës.

#### **Neni 19**

#### **Raportet nga Komisioni Mbikëqyrës i Odës**

1. Në përputhje me Ligjin në fuqi, Komisioni Mbikëqyrës i Odës bën përpilimin e raporteve të rregullta vjetore dhe atyre të jashtëzakonshme sipas kërkesës nga Ministria ose Kuvendi i Odës e në veçanti kur gjen shkelje të Statutit, akteve dhe vendimeve tjera të organeve të Odës.
2. Këto raporte i dorëzohen Kuvendit të Odës dhe publikohen në webfaqen e Ministrisë dhe Odës.
3. Bordi Drejtues i Odës detyrohet të vendos raportet nga ky Nen dhe propozimet e këtyre raporteve, në Rendin e Ditës të mbledhjes së menjëhershme të radhës të Kuvendit të Odës.
4. Kuvendi i Odës detyrohet të adresoj propozimet e bëra në raportet e Komisionit Mbikëqyrës kundrejt organeve të Odës dhe përcjell zbatimin e tyre.
5. Për këtë qëllim, Kuvendi i Odës merr masa të menjëhershme për evitimin e shkeljeve të identifikuar nga Komisioni Mbikëqyrës dhe, sipas nevojës, mund të krijojë komision të caktuar në përputhje me procedurën e Nenit 22 të kësaj Rregulloreje, me mandat të veçantë për të përcjellur zbatimin e masave nga organet përkatëse të Odës.

6. Dispozitat e këtij Neni zbatohen gjithashtu për raportet e Komisionit Ministror për Themelimin e Odës, i cili ushtron funksionin e Komisionit Mbikëqyrës gjatë periudhës së përkohshme të funksionimit të Odës.

## **KAPITULLI VI – PROCEDURA E MIRATIMIT TË AKTEVE NGA KUVENDI**

### **Neni 20**

#### **Procedura e miratimit të akteve të përgjithshme të Odës**

1. Në përputhje me Statutin e Odës, propozim aktet e përgjithshme të Odës i dorëzohen për miratim Kuvendit nga Bordi Drejtues.
2. Së bashku me propozimin për miratimin e aktit të përgjithshëm dorëzohet pëlqimi për aktin e përgjithshëm nga Ministria përgjegjëse për fushën e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit, i lëshuar në përputhje me Ligjin në fuqi.
3. Akti i përgjithshëm i propozuar prezantohet gjatë mbledhjes së Kuvendit nga Kryetari i Odës ose nga një nga anëtarët e autorizuar të Bordit Drejtues të Odës. Prezantuesi në formë të përmbledhur paraqet qëllimin e aktit dhe përmbajtjen e tij.
4. Amendamentet në aktin e përgjithshëm të propozuar mund të paraqiten nga Komisioni Mbikëqyrës i Odës ose së paku një e treta (1/3) e anëtarëve të rregullt të Odës. Të gjitha amendamentet e propozuara paraqiten me shkrim së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para mbajtjes së Mbledhjes së Kuvendit dhe përmbajnë arsyetimin e tyre si dhe referencën e qartë për nenin apo paragrafin që propozohet të amendamentohet. Bordi Drejtues i Odës sigurohet që të marr pëlqimin e Ministrisë për amendamentet e propozuara, në përputhje me Ligjin në fuqi.
5. Për secilin amendament të propozuar, paraqitësi i aktit të përgjithshëm ka të drejtë të jep përgjigje dhe opinionin eventual të Bordit Drejtues gjatë Mbledhjes së Kuvendit.
6. Në rast të paraqitjes së amendamenteve nga paragrafi 4 i këtij Neni, secili amendament në Mbledhjen e Kuvendit votohet fillimisht veçmas sipas radhës së Neneve. Pasi të gjitha amendamentet shqyrtohen, Kuvendi voton për miratimin e aktit të përgjithshëm.
7. Administrata e Odës siguron përgatitjen e versionit final të aktit të përgjithshëm të miratuar, me qëllim të publikimit.

8. Publikimi i akteve të përgjithshme të miratuara të Odës bëhet më së largu në afat prej pesë (5) ditë pas datës së miratimit.

## **Neni 21**

### **Procedura e miratimit të Buxhetit**

1. Bordi Drejtues i Odës i dorëzon Kuvendit për miratim propozim Buxhetin vjetor të Odës, jo më larg se njëzetënjë (21) ditë nga data e parashikuar e mbajtjes së Mbledhjes së Kuvendit.
2. Propozim Buxheti vjetor nga paragrafi 1 përfshin të hyrat e projektuara vjetore, shpenzimet e planifikuara dhe alokimet rezervë, në përputhje me planin e menaxhimit financiar të Odës.
3. Propozim Buxheti vjetor gjithashtu përmban pjesën narrative për prioritetet kyçe buxhetore dhe ndryshimet e bëra nga viti i kaluar dhe krahasimet me vitin fiskal paraprak.
4. Kryetari i Odës ose një nga anëtarët e autorizuar të Bordit Drejtues prezantojnë propozim Buxhetin vjetor në Mbledhjen e Kuvendit, i përcjellur nga një debat i strukturuar.
5. Amendamentet në shumën totale të propozim Buxhetit nuk janë të lejuara. Megjithatë, anëtarët e rregullt të Odës mund të propozojnë rialokime dhe ndryshime në kuadër të kategorive buxhetore, për çka zbatohet përshtatshmërisht procedura e amendamentimit të akteve të përgjithshme të Odës nga Neni 19 i kësaj Rregulloreje.
6. Në rast të mos miratimit të Buxhetit vjetor nga Kuvendi para fillimit të vitit fiskal, Oda do të funksionoj me rregulla të përkohshme financiare ku shpenzimet janë të limituara në ato esenciale dhe të bazuara në detyrimet e mara nga periudhat paraprake.
7. Gjatë periudhës së përkohshme të funksionimit të Odës, Buxheti i Odës caktohet dhe miratohet nga Ministria përgjegjëse për fushën e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit, në përputhje me Nenin 42 të Ligjit në fuqi që parasheh se mjetet për themelimin dhe funksionimin e Odës gjatë periudhës së përkohshme sigurohen nga Ministria në formë të grantit në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

## **Neni 22**

### **Procedura e krijimit të trupave të Kuvendit**

1. Në përputhje me Statutin e Odës, Kuvendi mund të krijoj komisione të caktuara, grupe punuese, këshilla profesionale apo grupe të ekspertëve, me mandat të caktuar, për çështje në kompetencë të Kuvendit.

2. Propozimi për krijimin e cilitdo trup nga paragrafi 1 i këtij Neni përfshihet si pikë e Rendit të ditës së Mbledhjes së Kuvendit sipas procedurës së përcaktuar në Nenin 7 të kësaj Rregulloreje.
3. Secili Propozim duhet të përmbaj:
  - 3.1. emrin e trupës që do të krijohet;
  - 3.2. qëllimin për krijimin e saj;
  - 3.3. emrat dhe rolet e anëtarëve të asaj trupe;
  - 3.4. fushëveprimin dhe përgjegjësitë;
  - 3.5. kohëzgjatjen e mandatit, dhe
  - 3.6. çështje tjera të rëndësishme për funksionimin e asaj trupe.
4. Në trupat e krijuara nga Kuvendi mund të angazhohen edhe persona apo zyrtarë jashtë anëtarësisë së Odës.
5. Propozimet shqyrtohen dhe votohen nga Kuvendi. Trupa konsiderohet e krijuar me miratimin formal nga Kuvendi.
6. Vendimi i Kuvendit duhet të reflektoj përmbajtjen e propozimit nga paragrafi 3 i këtij Neni dhe publikohet në webfaqen e Odës.
7. Secila trupë e Kuvendit mund të miratoj rregulla të brendshme të procedurës, për të udhëzuar punën e saj, takimet, vendim-marrjen apo praktikën e dokumentimit, me kusht që këto rregulla nuk janë në kundërshtim me Ligjin në fuqi dhe rregullativën përkatëse të Odës.
8. Secila trupë e Kuvendit përgatit raport periodik për Kuvendin, përmes Administratës së Odës, pas përfundimit të mandatit për të cilin është krijuar, përveç nëse Kuvendi kërkon raporte tjera të mëhershme.
9. Kuvendi me vendim mund të vazhdoj mandatin e një trupe të krijuar apo të shpërndaj të njëjtën bazuar në performancën e asaj trupe apo relevancën me zhvillimet në fushën e caktuar. Propozimi për shpërndarje të trupës ndjek procedurën e njëjtë si atë për krijimin e saj sipas këtij Neni.

### **Neni 23**

#### **Miratimi i rezolutave dhe rekomandimeve**

1. Në përputhje me Statutin, në Mbledhjen e Kuvendit mund të debatohet për çështje të cilat janë me interes të përbashkët për anëtarët e Odës, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin dhe kompetencat e Odës.
2. Për këto çështje mund të propozohen përfshirja e shqyrtimit dhe miratimit të projekt rezolutave apo projekt rekomandimeve në Rendin e Ditës sipas Nenit 7 të kësaj Rregulloreje.
3. Rezolutat paraqesin pozicionin formal të Kuvendit dhe mund të udhëzojnë veprimet e mëtutjeshme të organeve të Odës. Rekomandimet janë këshilluese dhe jo detyruese për organet e Odës apo edhe palët e jashtme, që shërbejnë në cilësinë e udhërrëfyesit për harmonizim të veprimeve me rregullativën e Odës apo legjislacionin në fuqi, përmirësimin e standardeve në fushën e inxhinierisë, harmonizimin me praktikatat më të mira apo çështje tjera për të cilët Kuvendi vlerëson se janë të nevojshme të miratohen rekomandime në përputhje me misionin e Odës.
4. Teksti i përgatitur i projekt rezolutës apo projekt rekomandimeve i bashkëngjitet propozimit për përfshirje në Rend të Ditës, dhe i njëjti mund të ndryshohet apo plotësohet gjatë zhvillimit të shqyrtimit dhe votimit në Kuvend.
5. Pas miratimit, rezolutat dhe rekomandimet e Kuvendit publikohen në webfaqen e Odës. Kuvendi mund të caktoj një nga organet e Odës për të mbikëqyrur zbatimin e rezolutës apo rekomandimeve, varësisht nga tema që trajtohet në to.

## **KAPITULLI VII – RREGULLAT PËR MBLEDHJET ONLINE**

### **Neni 24**

#### **Vendimi për mbajtjen e mbledhjeve *online***

1. Bordi Drejtues mund të vendos që Mbledhja e Kuvendit të mbahet *online*, në përputhje me Statutin e Odës.
2. Bordi Drejtues vendos për platformën digjitale që do të përdoret për mbajtjen e Mbledhjes. Platforma duhet të plotësoj së paku kërkesat në vijim:
  - 2.1. Platformë e sigurtë dhe e mbrojtur me fjalëkalim të miratuar nga Bordi Drejtues;
  - 2.2. Kriptimin *end-to-end* për të mbrojtur komunikimin;

- 2.3. Lidhjen unike për secilin pjesëmarrës, dhe
- 2.4. Funksionin kontrollues për Kryesuesin e Mbledhjes si dhe atë të mbështetjes logjistike nga Administrata e Odës.
3. Thirrja e Mbledhjes *online* bëhet sipas formës dhe procedurës së njëjtë siç është përcaktuar në Nenin 6 të kësaj Rregulloreje.
4. Bordi Drejtues cakton datën e fillimit dhe atë të mbarimit të Mbledhjes *online* të Kuvendit. Këto data bëhen të ditura në vendimin e Bordit nga paragrafi 1 i këtij Neni dhe në thirrjen për Mbledhje.
5. Administrata e Odës ofron përkrahje teknike për pjesëmarrësit për kyçe dhe gjatë kohëzgjatjes së Mbledhjes së Kuvendit.

#### **Neni 25**

##### **Vlefshmëria e pjesëmarrjes**

Pjesëmarrësit duhet të verifikojnë identitetin e tyre para se të marrin pjesë në Mbledhjen *online* të Kuvendit. Bordi Drejtues vendos për formën teknike të autentikimit të pjesëmarrësve.

#### **Neni 26**

##### **Kushtet e kuorumit**

Kuvendi ka kuorum në Mbledhje *online* kur më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të rregullt që e përbëjnë Kuvendin e Odës kanë përfunduar procedurat e identifikimit si pjesëmarrës në Mbledhjen e Kuvendit.

#### **Neni 27**

##### **Fjalimet dhe ndërhyrjet para Kuvendit**

1. Fjalimet dhe ndërhyrjet tjera para Kuvendit mbahen në kohe reale apo në formë të regjistruar (tekst ose video) të cilat vendosen në platformën e Mbledhjes *online*.
2. Fjalimet dhe ndërhyrjet nga paragrafi 1 i këtij Neni duhet të jenë në përputhje me formën e përshtatur me platformën digjitale përmes të cilës mbahet Mbledhja.
3. Kryesuesi i Mbledhjes mbështetet nga Administrata e Odës për rishikimin e fjalimeve dhe ndërhyrjeve të regjistruara, për të siguruar që ato janë relevante, në përputhje me rregullat e etikës

dhe të përshtatshme teknikisht. Përmbajtja e cila nuk i plotëson këto kushte, largohet nga platforma e Mbledhjes *online*.

#### **Neni 28**

##### **Votimi në Mbledhjen *online***

1. Votimi për pikat përkatëse të Rendit të Ditës bëhet përmes funksionit të caktuar në platformë. Kryesuesi i Mbledhjes cakton kohëzgjatjen e arsyeshme dhe të përshtatshme gjatë së cilës pjesëmarrësit në Mbledhje kanë të drejtë të votojnë.
2. Rezultatet e votave shpallen menjëherë pas mbylljes së kohës për votim.
3. Votimi i fshehtë bëhet përmes formës së përshtatshme teknike të përcaktuar nga platforma. Në këto raste rezultati shfaqet në mënyrë kumulative dhe nuk përfshin identifikimin e votave individuale.
4. Platforma siguron pengimin e votave të dyfishta dhe atyre të paautorizuara.

#### **Neni 29**

##### **Regjistrimet e Mbledhjes**

Të gjitha zhvillimet në Mbledhjen *online* të Kuvendit regjistrohen dhe arkivohen nga Oda në formatin përkatës të vendosur nga Bordi Drejtues.

#### **Neni 30**

##### **Udhëzuesi dhe testimi i përdorimit të platformës**

Administrata e Odës, pas miratimit nga Bordi Drejtues i Odës, publikon Udhëzuesin për përdorimin e platformës digjitale përkatëse që do të përdoret për Mbledhjet *online* të Kuvendit. Administrata teston platformën dyzetetë (48) orë përpara çdo mbledhjeje.

#### **Neni 31**

##### **Zbatimi i dispozitave tjera**

Të gjitha dispozitat nga kjo Rregullore për mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit nga kapitujt II deri VI të kësaj Rregulloreje, zbatohen përshtatshmërisht për Mbledhjet *online*.

### **KAPITULLI VIII – DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 32**

### **Mbizotërimi i dispozitave**

Dispozitat që rregullojnë themelimin e organeve të Odës pas periudhës së përkohshme nga Neni 49 i Ligjit në fuqi dhe aktet përkatëse të Ministrisë përgjegjëse për fushën e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit apo të Komisionit Ministror për Themelimin e Odës, sa i përket zgjedhjes së këtyre organeve, mbizotërojnë mbi këtë Rregullore.

### **Neni 33**

#### **Interpretimi i Rregullores**

Të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje e ka Bordi Drejtues i Odës, pas konfirmimit të interpretimit të propozuar me votim nga Kuvendi.

### **Neni 34**

#### **Hyrja në Fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi dhe publikohet në webfaqen e Odës.

**Arsim Rapuca**

**Kryetar i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës**

